

**PRIVATIZIMI NË KOSOVË**  
**PRIVATIZIMI NË KOSOV**  
**PRIVATIZIMI NË KOSOVË**  
**PRIVATIZIMI NË KOSOVË**  
**PRIVATIZIMI NË KOSOVË**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVO – REPUBLIC OF KOSOVO**

**AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT**  
**KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU – PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO**

**Maj 2009**



## SI TË PARAQES OFERTËN PËR NJË NDËRMARRJE NË PRONËSI SHOQËRORE – NSH?

### ***Pasqyrë e përgjithshme e Programit të Privatizimit në Kosovë***

•Kosova gjendet në qendrën e ekonomive kumbuese të Evropës Juglindore. Ky territor ka qenë nën administrim të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) që nga Qershori i vitit 1999. Më shpalljen e pavarësisë më 17 Shkurt 2008 dhe me njohjet ndërkombëtare të shteteve më të fuqishme ekonomike dhe më demokratike të botës, Kosova ka mënjeluar pengesën e fundit politike për tërheqjen e investitorëve të huaj. Duke i dhënë prioritet të parë rritjes ekonomike, Qeveria e Kosovës gjithashtu është zotuar të vazhdojë me reformat ekonomike në mënyrë që të bëjë vendin më atraktiv për investitorët e huaj.

•Kosova ka tatime të ulëta dhe një sistem të thjeshtë të tatimit me reforma fiskale shtesë të planifikuara nga qeveria. Për më tepër ofron stabilitet makroekonomik, procedura të thjeshta dhe të shpejta të regjistrimit të biznesit, ndërsa Euro përdoret si monedhë zyrtare e saj, një fuqi pune dinamike të re dhe të arsimuar mirë. Me anëtarësimin në CEFTA, në të vërtetë investitorët që vijnë në Kosovë do të futen në tregun e 28 milion njerëzve. Veç kësaj, Kosova është e liruar nga dogana në tregun e BE-së bazuar në regjimin e preferencës autonome të BE-së për tregti (PAT).

•Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si një organ i pavarur

publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur sipas Ligjit të Kuvendit të Kosovës për AKP-në Nr. 03/L-067, i cili ka hyrë në fuqi më 15 Qershor 2008. Ky ligj implementon dispozitat përkatëse të Propozimit Gjithëpërfshirës të datës 26 Mars 2007 (Aneksi VII, neni 2), i cili është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

•AKP-ja themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të AKP-së.

•Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ndërsa anëtarët ndërkombëtar të AKP-së janë emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi themelimin e AKP-së dhe ky bord ka autoritet të plotë mbi AKP-në.

•Mbi 590 ndërmarrje biznesi në Kosovë janë identifikuar të jenë potencialisht Ndërmarrje Shoqërore (“NSH”). NSH-të operojnë në sektorë të ndryshëm përfshirë procesimin e metalit, plastikë, letër, hotele, minierë, agro-industrial, pylltari, material ndërtimi, ndërtim, verari dhe vreshtari, berrori, tregti me shumicë dhe pakicë.

•Një pasqyrim i programit të privatizimit tregon që 30 valët e tenderëve të privatizuar me sukses janë kryer deri më 30 Qershor 2008 nga Agjencia paraardhëse (AKM-ja), dhe 3 valët e privatizimit deri në Dhjetor 2008 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me shitjen e NSH-ve në sektor të ndryshëm të investitorëve vendor, rajonal dhe investitorëve ndërkombëtar.

## AKP-ja do të vazhdoj me privatizime përmes tri metodave:

- **“Spin of-i”**- Asetet dhe një numër i kufizuar i detyrimeve të NSH-ve janë transferuar në shoqëritë aksionare të themeluara rishtazi (“Ndër e Re-ja”) me aksionet e kompanive të reja më pas të tenderuara për shitje për investitorët privat. Detyrimet e mbetura dhe punëtorët mbeten me NSH-në. Spin of-et më të suksesshme priten të jenë në sektorët të cilët kryejnë punën më së miri; këto janë procesimi bujqësor, e cila përfshinë verarinë dhe subjektet që merren me përpunimin e ushqimit, sektori i materialit ndërtimor, miniera, dhe procesimi i metalit.
- **“Spin of-i special”**: Është i ngjashëm me spin-of-in, mirëpo e lejon AKP-në të vendos kushte në tender (për shembull, shkallen minimale të punësimit, zotimet e investimeve, të mbajnë linjën e njëjtë të biznesit). Në përgjithësi Spin of-et speciale përdoren vetëm për NSH-të e mëdha dhe shumë strategjike.
- **Likuidimi vullnetar**: NSH-të të cilat nuk kanë shanse për sukses dhe është e qartë që nuk kanë perspektivë të mbijetojnë, Likuidimet lejojnë një dalje nga tregu pa shpenzime. Në përgjithësi asetet e tyre do të likuidohen përmes ankandit publik..

LEXUESIT DUHET TË VËREJNË QË KY DOKUMENT ËSHTË VETËM PËRMBLEDHJE E PROCESIT. RREGULLAT E TENDERIT DO TË UDHËHEQIN PROCESIN E TENDERIT DHE JO KËTË DOKUMENT. PRANDAJ OFERTUESIT DUHET T’U REFEROHEN RREGULLAVE TË TENDERIT LIDHUR ME OFERTËN E TYRE DHE TË MOS I REFEROHEN KËTIJ DOKUMENTI. NËSE EKZISTON NDONJË MOSPËRPUTHJE NDËRMJET KËTIJ DOKUMENTI DHE RREGULLAVE TË TENDERIT, RREGULLAT E TENDERIT DUHET TË ZBATOHEN.

INFORMATAT MË POSHTË KANË TË BËJNË ME OFERTIMIN PËR NDËR. E. REJA VETËM PËR SPIN OF-ET E RREGULLTA. NË RAST TË SPIN-OFIT SPECIAL ZBATOHEN RREGULLAT TJERA.

## Çka shet AKP-ja ?

Në përgjithësi, AKP-ja shet asetet dhe obligimet aktuale të NSH-ve (**të përcaktuara për tre muajt e fundit të llogarive të pagueshme të papaguara dhe vitin e fundit të TVSH-së së papaguar**). Investitorët paraqesin ofertë vetëm për asete – dhe vetëm për disa detyrime aktuale – të NSH-së. **Nuk paraqesin oferta për vetë NSH-në**. Në këtë dokument, **“NDËR E RE”** i referohet aseteve dhe detyrimeve aktuale të NSH-së të shitura nga AKP-ja.

Ndonjëherë AKP-ja ndanë NSH-në në disa Ndër te Reja të vogla. Ju lutem sigurohuni që keni bërë ofertën për NDËR E RE e cila posedon asetet për të cilat jeni të interesuar. Memorandumi për Informim (shih më poshtë) përmban përshkrime të hollësishme të të gjitha aseteve që i takojnë secilës NDËR. TË. RE.

### Si të paraqes ofertën për një NDËR E RE?

- 1) Investitorët e interesuar duhet të kontaktojnë AKP-në dhe të marrin Rregullat e Tenderit për NDËR E RE specifike. Këto Rregulla të Tenderit do të udhëheqin procesin e tenderit.
  - 2) Rishikimi i Memorandumit për informim, shqyrton të dhënat konfidenciale në Selinë e AKP-së ose Zyret Rajonale të AKP-së, bënë vizita me stafin e AKP-së në NSH Ndër e Re, dhe kryen Hulumtimin Paraparak.
  - 3) Para kualifikimi (shiko më poshtë).
  - 4) Dorëzon ofertën në datën e dorëzimit të ofertës
- i) Merr pjesë në hapjen e Ofertës (nuk është e domosdoshme)

### Si të filloj hulumtimin tim mbi një Ndër. të. Re të cilën dëshiroj të blejë?

- Viziton faqen e internetit të AKP-së, [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org), dhe lexon pjesët përkatëse. Dokumentet për Ndërmarrje janë ta gatshme për secilën Ndër. të. Re.
- Po ashtu ju duhet të shkarkoni modelin "Rregullat e Tenderit" dhe të lexoni atë me kujdes. Mirëpo kushtoni vëmendje që secila NDËR. E. RE do të ketë "Rregulla të Tenderit" të veçanta për secilën, e cila duhet të merret në AKP dhe e cila do të udhëheq procesin e tenderit për "NDËR. E. RE" përkatëse.
- Kontakton AKP-në dhe cakton takim me përfaqësuesit e Departamentit të Shitjes/ Njësia për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor në zyrën kryesore në Prishtinë ose në ndonjërin prej zyrave rajonale. Numri kryesor në Departamentin e Shitjes – Zyra e Njësies për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor në AKP është +381 (0) 500-400-1255. Zyret Rajonale të AKP-së janë në Prishtinë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë dhe Prizren.

### Çfarë informatash duhet të kërkoj nga AKP-ja?

Duhet të kërkojnë **Dokumentet e Ofertës** për NDËR. E. RE për të cilën janë të interesuar të blejnë.

- Ekzistojnë Dokumente specifike të Ofertës për secilën NDËR. TË. RE.
- Nënshkruan Marrëveshjen mbi ruajtjen e sekretit afarist për Ndër e Re për të cilën dëshironi të ofertoni.
- Pas nënshkrimit të Marrëveshjes mbi ruajtjen e sekretit afarist ju do të pranoni Memorandumin e Informatave, informata nga zyra e të dhënave, dokumentet ligjore dhe rreziqet tjera si dhe informatat tjera përkatëse.
- Gjithashtu mund të vizitoni Ndër. e. Re për të cilën jeni të interesuar.
- Hulumtimi paraparak – studimi, mbledhja dhe analiza e informatave është përgjegjësi e secilit ofertues.

### Çka tjetër duhet të bëj para hapjes së ofertave?

Duhet të para-kualifikoheni si ofertues i regjistruar.

### Si duhet të para-kualifikohem si ofertues i regjistruar?

**Shiko rregullat e aplikueshme të tenderit për detaje tjera rreth para-kualifikimit dhe informata se çfarë dokumentacioni duhet të dorëzohet. SË PAKU 5 DITË PUNE** para datës për dorëzimin e ofertave, duhet të dorëzoni dokumentet në vijim në Departamentin e Shitjes/Zyrën e Njësies për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitor në AKP, Prishtinë.

## 1. Informatat tuaja për kontakt.

■ Kjo është një letër ku janë të shkruara:

- Emri i juaj
- Adresa e rrugës suaj
- Qyteti dhe Shteti i juaj
- Numri i juaj i telefonit & faksit elektronik (emaili) e juaj
- Të dhënat e mësipërme lidhur me ndonjë përfaqësues

## 2. Deklarata e Agjencisë

Nëse jeni përfaqësues i ndonjë entiteti, duhet të identifikoni atë entitet dhe të ofroni certifikatën që tregon se ju (përfaqësuesi) nuk jeni nën hetime.

## 3. Deklarata e kualifikueshmërisë

Kjo letër duhet të shkruhet nga ju. Kjo letër tregon që ju jeni kualifikuar në proces të tenderit. Nuk mund të paraqitni ofertën nëse jeni në falimentim, ose jeni nën ndonjë hetim për krime. (Institucionet e qeverisë, NSH-të dhe NP-të nuk mund të paraqesin oferta. Punëtorët e institucioneve qeveritare, NSH-ve dhe NP-ve mund të dorëzojnë ofertat individualisht ose në grup.) *Shiko nenin 3 të Rregullave të aplikueshme të Tenderit për listën complete të ofertuesve të pa-kualifikueshëm.*

## 4. Kopja e vërtetuar e letërnjoftimit ose pasaportës


nëse ju paraqitni ofertë si individ, duhet të dorëzohet kopja e lejës suaj të njoftimit /pasaportës si dhe certifikata e cila tregon se ju nuk jeni nën hetime.

## 5. Kopja e vërtetuar e certifikatës së regjistrimit të biznesit

nëse parashtroni ofertën si subjekt ligjor, dhe një listë të pronarëve përfitues të subjektit ligjor dhe personat kontrollues me dokumente mbështetëse. *Shiko nenin 6.4 të Rregullave të aplikueshme të tenderit për detaje.* Gjithashtu duhet të siguroni vërtetimin që dëshmon se pronari/ët dhe/ose personat kontrollues nuk janë nën hetim. Rregullat e Tenderit gjithashtu caktojnë kërkesa të tjera të caktuara nëse ofertoni si bashkëpjesëmarrës ose në konsorcium.

## Çka ndodh pas dorëzimit të dokumenteve për para-kualifikim si Ofertues i Regjistruar?

Departamenti i Shitjes – Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor në AKP, do të lëshoj një “Certifikatë të Ofertuesit të Regjistruar” (dhe numrin e regjistrimit të kualifikueshmërisë) të cilin ju duhet të vendosni në zarfin “Informatë shtesë për ofertën”.



# FORMULARI PËR REGJISTRIM TË KUALIFIKUESHMËRISË – DO TË LËSHOHET NGA AKP-JA PAS REGJISTRIMIT

Certifikata për Regjistrimin e Ofertuesit				
Të dhëna				
Emri				
Adresa				
Telefoni				
Posta elektronike (email)				
Lloji i Regjistrimit	Person fizik	Subjekt Ligjor	Bashkëpjesëmarrës	Konsorcium
Të bashkangjiturat	1			
	2			
	3			
	4			
	5			
	6			
	7			
	8			

- Në emër të ofertuesit, nëpërmjet kësaj deklaroj që ofertuesit nuk është i ndaluar ofertimi sipas nenit 3.1 të Rregullave të Tenderit dhe të gjithë ato që janë të bashkangjitura janë të sakta.

Data: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

## Të plotësohet nga AKP-ja

Me anë të kësaj konfirmoj që \_\_\_\_\_ ka para-regjistruar dokumentet e kualifikueshmërisë-ofertës së tij në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ne përkohësisht kemi regjistruar me numër ofertuesin. AKP-ja do të shqyrtoj dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi. Ofertuesi mund të përdor për pjesëmarrje këtë certifikatë të regjistrimit të ofertuesit në të gjithë tenderët e privatizimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Nëse konsiderohet se ofertuesi i mundshëm nuk i është përmbajtur nenit 3.1 të Rregullave të Tenderit, AKP-ja rezervon të drejtën të tërheq regjistrimin e ofertuesit në çdo kohë madje edhe pasi që të jenë dorëzuar ofertat.

Data: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Vula

--

# TË DHËNAT LIDHUR ME DOKUMENTET E OFERTIMIT

## Si duhet të paraqes dokumentet për ofertim?

Ju duhen **3 zarfe për ofertë** që të përmbaj **Ofertën** tuaj.

1. Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një zarf të madh e të mbyllur: Zarfi **“Oferta për numër të tenderit [ ]”**.

## Brenda këtij zarfi, ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura:


2. Zarfi **“Informatat shtesë për Ofertën”**.
3. Zarfi **“Çmimi i Ofertës”**.

**Çfarë dokumentesh kërkohen?  
Si të rregulloj dokumentet në këto zarfe?**

## Hapi 1

Të gjitha dokumentet dhe zarfet e vendosura më poshtë duhet të vendosen në një zarf të madh. (Ky është zarfi **“Oferta për Tender \_\_\_\_\_”**.)

Në pjesën e jashtme të këtij zarfi duhet të shkruani me shkronja të mëdha **“Oferta për Tender AKP XXX Emri i Ndër e Re”** (ju lutem vendoseni **Numrin e Tenderit** në vend të XXX dhe emrin aktual të Ndër e Re në vend të “Ndër e Re ABC”). Ju lutem shikoni shembullin më poshtë.



## Hapi 2

Brenda zarfit **“Oferta për Tender”** duhet të vendosni zarf tjetër të shënuar **“Informata shtesë për Ofertën”**. Gjithashtu në këtë zarf duhet të shënoni numrin e tenderit të ofertës. Ju lutem shikoni shembullin më poshtë:

**Informata shtesë për Ofertën**  
**AKP (numri i tenderit)**  
**Ndër e Re ABC**



**Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit**  
**“Informata shtesë për Ofertën”:**

- 1) Një kopje të certifikatës për regjistrimin e kualifikueshmërisë të lëshuar sipas nenit 6 të Rregullave të tenderit të AKP-së.
- 2) Originali i një dokumenti të nënshkruar nga ose në emër të ofertuesit, ku thuhet që ofertuesi pajtohet t'i nënshtrohet Rregullave të Tenderit – SHTOJCA “C”
- 3) Dokumenti bankar origjinal nga një bankë e mirënjohur i cili konfirmon që ofertuesi do të ketë qasje në fonde të mjaftueshme gjatë gjithë periudhës së tenderit për të paguar çmimin e plotë dhe kapitalin themelues fillestar. AI DOKUMENT BANKAR NUK DUHET TË JAP VLERËN E ÇMIMIT TË OFERTËS SË OFERTUESIT. Banka nuk duhet të jetë bankë e regjistruar në shtetin i cili është në listën e zezë të GRUPIT PUNUES PËR VEPRIME FINANCIARE (GPVF)
- 4) Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e caktuar të AKP-së (shiko fundin e dokumentit për hollësi), dhe
- 5) Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së (shiko fundin e dokumentit për hollësi).

**AKP-ja ka formularë për disa nga dokumentet e lartpërmendura.**  
**Të gjitha këto dokumente do t'i gjeni në fund të këtij dokumenti.**

## Hapi 3

Brenda këtij zarfi **“Oferta për tender”** gjithashtu duhet të vendosni zarfin e tretë të mbyllur, zarfin **“Çmimi i Ofertës”**.

**Çmimi i Ofertës**  
**AKP (numri i tenderit)**  
**Ndër e Re ABC**



Brenda zarfit **“Çmimi i ofertës”** duhet të vendosni një letër ku jepen detajet e çmimit të ofertuar. Informata mbi çmimin i ofertës duhet të duket si më poshtë:



# ÇMIMI I OFERTËS

VENDOSINI ÇMIMIN E OFERTËS QË SYNONI TË PAGUANI PËR SUBJEKTIN E RI NË SHIFRA

Qindra milionë	Dhjetëra milionë	Miliona	Qindra mijëra	Dhjetëra mijëra	Mijëra	Qindra	Dhjetëra	Njësitë

## NË FJALË

( \_\_\_\_\_ )

**SHËNIM 1:** NË RAST TË NDOJË MOSPËRPUTHJE NË MES TË SHIFRAVE NË TABELËN E MËSIPËRME DHE SHUMËS SË DHËNË NË FJALË MË LARTË, KJO E FUNDIT (SHUMA NË FJALË) DO TË MBIZOTËROJ DHE DO TË LEXOHEK DHE TRAJTOHEK SI ÇMIMI I OFERTËS SË OFERTUAR. NË RASTET KUR SHUMA E PARAQITUR NË SHIFRA DHE NË FJALË NUK ËSHTË E QARTË, OFERTA E OFERTUESIT DO TË DISKUALIFIKOHEK.

**SHËNIM 2:** OFERTUESIT POTENCIAL DUHET TË JENË NË DIJENI QË PËRVEÇ ÇMIMIT TË OFERTËS, ATA JANË TË OBLIGUAR TË PAGUAJNË SHUMËN SHITESË PREJ 1.250,00 EURO, QË ËSHTË SHUMA E KAPITALIT THEMELUES FILLESTAR PËR THEMELIMIN E SUBJEKTIT TË RI PËR TË CILIN AGJENCIA DUHET TË KOMPENSOHEK.

## Përmbledhje

Zarfi i mbyllur **“Informatë shtesë për Ofertën”** përmban “Certifikatën mbi Regjistrimin e Ofertës”, letrën bankare, dokumentin me anë të të cilit pajtohet me Rregullat e Tenderit (Shtojca “C”), konfirmimin e pagesës së tarifës për dorëzim të ofertës dhe konfirmimin e pagesës së depozitit të kthyesëm

Zarfi i mbyllur me **“Çmimin e Ofertës”** përmban një dokument ku tregohet çmimi i juaj i ofertës.

Këto dy zarfe futen brenda zarfit me mbishkrimin **“Ofertë për Tenderin numër XXX”** i cili më pas vulozet dhe dorëzohet në zyrën e AKP-së në Prishtinë.

### Kur pranohen ofertat?

- Ofertat pranohen vetëm kur dorëzohen me dorë prej orës 10:00 deri 12:00 në Datën e Dorëzimit të Ofertës, në Zyrën Qendrore të AKP-së në Prishtinë.  
Këto oferta do të hapen në Qendrën e Rinisë – Salla e Kuqe në Prishtinë prej orës 13:00 deri 15:00.

### A mund të dorëzohet ofertën time përmes postës?

- Jo, Ju DUHET TË DORËZONI ME DORË ZARFET E OFERTËS.

### A duhet të dorëzohet Ofertën personalisht?

- Jo, Ju mund të dërgoni ndonjë mik ose përfaqësues. Ata do të pranojnë një fletëpranim.

### Ku duhet të dorëzohet Ofertën time?

- AKP do të pranojë dokumentet e ofertës vetëm në një vend:
  - Selia e AKP-së në Prishtinë
  - Rr Ilir Konushevc Nr. 8
  - Prishtinë, Kosovë

## A mund të shpjegoni pak më shumë secilin nga dokumentet e ofertës?

Po.

- **Certifikata e Regjistrimit të Kualifikueshmërisë** – Kjo është një certifikatë që konfirmon se ju jeni një ofertues i kualifikueshëm. AKP-ja do të lëshoj këtë certifikatë kur ju të para-kualifikoheni. Shiko nenin 3 në “Rregullat e Tenderit”.
- **Deklarata e Nënshkruar** – me të cilën pajtoheni me kushtet e ofertës dhe rregullat e tenderit (Shtojca C) – shiko neni 8.3 (a) (i) në “Rregullat e Tenderit” dhe formularin në fund të këtij dokumenti.
- **Dokumenti bankar** – shiko nenin 8.3 (a) (iii) në “Rregullat e Tenderit” dhe formularin në fund të këtij dokumenti. Tarifa e dorëzimit të ofertës 1,000€ (një mijë Euro) – kjo shumë është e pakthyeshme dhe duhet t’i paguhet AKP-së përmes transferit bankar. Shiko detajet e llogarive bankare në fund të këtij dokumenti.
- **Depozita e kthyeshme** – kjo depozitë është e kthyeshme (do të kthehet në rast se nuk shpalleni fitues i ofertës) dhe gjithashtu duhet të paguani përmes transferit bankar. Mos paguani me para të gatshme ose me çek personal. Shuma e depozitit ndryshon për secilën NDËR E RE që shitet. Për të kuptuar shumën për Depozitën e kthyeshme për NDËR e RE të cilën jeni të interesuar për të blerë, kontakto Departamentin e Privatizimit në AKP. Shiko detajet e llogarisë bankare në fund të këtij dokumenti.
- **Zarfin me çmim të ofertës (zarfi me “Çmim të ofertës”)** – Shiko me vëmendje nenin 8.3(c) të “Rregullave të Tenderit” – “Nuk duhet të ketë informata tjera të shkruara në pjesën e jashtme të këtij zarfi dhe asnjë informatë ose shenjë që mund të identifikoj Ofertën.”
- **A do të ketë asistencë në dispozicion?**  
Po. Staf i AKP-së do të jetë i gatshëm t’i përgjigjet pyetjeve dhe do të ofroj informata lidhur me procesin e ofertimit.

# DOKUMENTET NË VIJIM DUHET TË VENDOSEN BRENDA ZARFIT

## “Informata shitesë për Ofertën”:

FORMULARI I REGJISTRIMIT TË KUALIFIKUESHMËRISË SË OFERTËS  
– DO TË LËSHOHET NGA AKP-ja PAS REGJISTRIMIT

Certifikata për Regjistrimin e Ofertuesit				
Detajet				
Emri				
Adresa				
Telefon				
Posta elektronike				
Lloji i Regjistrimit	Personi fizik	Entiteti Ligjor	Bashkëpjesëmarrës	Konsorcium
Të bashkangjiturat	1			
	2			
	3			
	4			
	5			
	6			
	7			
	8			

- Në emër të ofertuesit, nëpërmjet kësaj deklaroj që ofertuesit nuk i ndalohet ofertimi sipas nenit 3.1 të Rregullave të Tenderit dhe të gjitha ato që janë bashkangjitur janë të sakta.

Data: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

### Të plotësohet nga AKP-ja

Me anë të kësaj konfirmojmë që \_\_\_\_\_ ka para-regjistruar dokumentet e kualifikueshmërisë së ofertës së tij në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ne përkohësisht e kemi regjistruar ofertën me numër. AKP-ja do të shqyrtoj dokumentacionin e ofruar nga ofertuesi. Ofertuesi mund të përdor këtë certifikatë të regjistrimit të ofertuesit për pjesëmarrje në të gjithë tenderët e ardhshëm për privatizim. Nëse konsiderohet se ofertuesi i mundshëm nuk është në pajtueshmëri me nenin 3.1 të Rregullave të Tenderit, AKP-ja rezervon të drejtën të tërheq regjistrimin e ofertës në çdo kohë madje edhe pasi që të jenë dorëzuar ofertat.

Data: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Vula

--

## ANEKSI C FORMULARI PËR DORËZIM TË OFERTËS

**Për:** Agjencinë Kosovare të Privatizimi  
Rr. Ilir Konushevc Nr. 8  
Prishtinë  
Kosovë

**Të Nderuar zotërinjë,**

Emri i plotë i Ofertuesit: \_\_\_\_\_

Numri i regjistrimit të kualifikueshmërisë së ofertuesit: \_\_\_\_\_

Emri i Ndër e Re /Subjektit të Ri: \_\_\_\_\_

Nr i tenderit: \_\_\_\_\_

Ofertuesi paraqet ofertën për Ndër. e Re/Subjektin e Ri të lartpërmendur:

**Bashkangjitur është:**

DOKUMENTI	BASHKANGJITUR PO OSE JO?
Kopja e formularit për regjistrimin e kualifikueshmërisë së përmendur në Rregullat e Tenderit	
Dokumenti bankar origjinal nga një bankë e mirënjohur (p.sh. një bankë e cila nuk është regjistruar në një vend i cili është në "listën e zezë" të Grupit Punues për Veprime Financiare (FTAF)), i cili konfirmon që ofertuesi do të ketë qasje në fonde të mjaftueshme gjatë gjithë periudhës së tenderit për të paguar çmimin e plotë dhe kapitalin themelues fillestar. Ai dokument bankar nuk paraqet vlerën e çmimit të ofertës së ofertuesit.	
Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së	
Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës (që përmendet në Rregullat e Tenderit) është transferuar në llogarinë përkatëse	

## Ofertuesi (i emërtuar më lart) në dorëzimin e kësaj Oferte:

- Konfirmon që mbetet i kualifikueshëm për ofertim sipas nenit 3.1 të Rregullave të Tenderit
- Pranon dhe pajtohet të jetë në përputhje me Rregullat e Tenderit
- Konfirmon që ka pranuar dhe lexuar Memorandumin për Informim për Ndër e Reja dhe Marrëveshjet për Shitje.
- Pajtohet që është informuar se ekziston Zyra e Dhënave e cila përmban informata të rëndësishme të cilat mund të ndikojnë në vendimin e tij për ofertim/çmimin e ofertës së tij, përfshirë dokumentin e quajtur "Dokument i Caktuar Ligjor dhe Rreziqe tjera"
- Pajtohet që i është dhënë mundësia të vizitoj Zyrën e të Dhënave ose ka vizituar Zyrën e të Dhënave ose qëllimisht ka rrezikuar të mos vizitoj Zyrën e të Dhënave
- Nëse shpallet ofertues fitues pajtohet të hyjë në Marrëveshje të Shitjes në mënyrë substanciale në formë dhe përmbajtje të modelit Marrëveshje për Shitje e ofruar në Dokumentet e Ofertës.

### Nënshkrimi

#### Për dhe në emër të Ofertuesit

Emri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

## MODELI I DOKUMENTIT BANKAR

KY DOKUMENT DUHET TË PËRFSHIHET NË NJË  
ZARF NDARAS NGA ÇMIMI I OFERTËS  
KY DOKUMENT NUK DUHET TË PËRMBAJ SHUMËN  
E ÇMIMIT TË OFERTËS SË OFERTUESIT

### [TË SHKRUHET NË KRYEFAQE NGA BANKA]

**Për:** Agjencinë Kosovare të Privatizimit  
Rr. Ilir Konushevc Nr. 8  
Prishtinë  
Kosovë

**Nga:** [shkruaj emrin e Bankës]

**Re:** Ofertuar nga [shkruaj emrin e ofertuesit]  
për [shkruaj emrin e Ndër e Re/Subjektit të ri]

Ne theksojmë që [shkruaj emrin e ofertuesit] është klient i bankës tonë. Kemi diskutuar synimin e [shkruaj emrin e ofertuesit] për të dorëzuar ofertën për blerjen e [shkruaj emrin e Ndër. së re /Subjektit të Ri], në përputhje me numrin e ofertës për tender të AKP-së [shkruaj numrin e ofertës për tender të AKP-së].

Pas shqyrtimit të fondeve të [shkruaj emrin e ofertuesit] të depozituara në llogaritë bankare të tij/saj në bankën tonë dhe burime të tjera të tij/saja të fondeve, ne besojmë që ai do të ketë qasje në fonde për të paguar shumën e ofertës së tij/saj dhe shpenzimet përkatëse (që përfshijnë, mirëpo nuk kufizohen me 1,250 euro sa i përket kapitalit themelues fillestar) gjatë kohëzgjatjes së tenderit, në përputhje me kërkesat dhe afatet e fundit të përcaktuara në rregullat e zbatueshme për tender. Ne konfirmojmë se jemi bankë e regjistruar në [shkruaj vendin] dhe e cila nuk është në 'listën e zezë' të Grupit Punues për Veprime Financiare (FATF)).

### Sinqerisht i juaji,

Emri i nënshkruesit: \_\_\_\_\_

Titulli i nënshkruesit \_\_\_\_\_

Emri i Bankës: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

## LLOGARITË BANKARE TË AKP-së:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej **1,000 € (një mijë Euro)** duhet të paguhet në llogarinë e AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është:

**1000435010000222**

Depozita e ofertës duhet të paguhet në llogarinë e AKP-së në BQK.

Numri i llogarisë është:

**1000435000000104**

---

**Shënim: Pajesa e tarifës së dorëzimit të ofertës dhe depozita e ofertës duhet të jetë si në vijim:**

- Qëllimi për: Privatizimi (Numri i valës) AKP-së dhe emri i Ndër e Re,
- Nga: Emri i ofertuesit siç është para-kualifikuar.

NË ZARFIN "INFORMATË SHITESË PËR OFERTËN" DUHET TË VENDOSNI ORIGINALIN E FLETËPAGESËS LËSHUAR NGA BANKA. KOPJET E FLETËPAGESËS NUK PRANOHEN.

---

Brenda zarfit “Çmimi i ofertës” duhet të përfshihet një letër, e cila përfshinë detajet e çmimit të ofertës suaj. Informata mbi çmimin e ofertës duhet të duket si në vijim:

## ANEKSI B

### “ÇMIMI I OFERTËS TË CILIN OFERTUESI I PËRKOHSHËM FITUES DUHET T’I PAGUAJ AGJENCISË”

Emri i plotë i ofertuesit të kualifikueshëm: \_\_\_\_\_  
 Numri i regjistrimit të kualifikueshmërisë së ofertuesit: \_\_\_\_\_  
 Emri i Subjektit: Ndër e Re \_\_\_\_\_ SH.P.K.  
 Nr Tenderit: \_\_\_\_\_

#### ÇMIMI I OFERTËS – SHKRUANI ÇMIMIN E OFERTËS NË SHIFRA QË DO TË PAGUANI PËR SUBJEKTIN E RI

Qindra milionë	Dhjetëra milionë	Miliona	Qindra mijëra	Dhjetëra mijëra	Mijëra	Qindra	Dhjetëra	Njësitë

NË FJALË [ \_\_\_\_\_ ]

**SHËNIM 1:** NË RAST TË NDONJË MOSPËRPUTHJEJE NDËRMJET SHIFRAVE NË TABELËN MË LART DHE SHUMËN NË FJALË TË VENDOSUR MË LART, KJO E FUNDIT (SHUMA NË FJALË) DO TË MBIZOTËROJË DHE DO TË LEXOHE E TRAJTOHE SI ÇMIMI I OFERTËS PËR OFERTIM. NË RASTET KUR SHUMA E PËRSHKRUAR NË SHIFRA DHE NË FJALË NUK JANË TË LEXUESHME, OFERTA E OFERTUESIT DO TË DISKUALIFIKOHE.

**SHËNIM 2:** OFERTUESIT POTENCIAL DUHET TË JENË NË DIJENI QË PËRVEÇ ÇMIMIT TË OFERTËS JANË TË OBLIGUAR TË PAGUAJNË EDHE SHUMËN SHITESË PREJ 1.250,00 EURO, QË ËSHTË SHUMA E KAPITALIT THEMELUES FILLESTAR PËR THEMELIMIN E SUBJEKTI PËR TË CILËN AGJENCIA DUHET TË KOMPENSOHE

\_\_\_\_\_  
 Nënshkrimi për dhe në emër të ofertuesit të kualifikueshëm

Ky nënshkrim gjithashtu konfirmon që ofertuesi i kualifikueshëm kupton shënimet e mësipërme dhe pajtohet të jetë i obliguar me deklaratimet e bëra këtu.

Emri & mbiemri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_



# LISTA REFERUESE E SHPEJTË PËR AGJENCITË DHE RREGULLORET

Agjencia/ Rregullorja	Përmbledhje	Data/Numri i Ligjit / Rregullorja	Linku i uebit
Agjencia Kosovare e Privatizimit	Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar për të: <ul style="list-style-type: none"> <li>Privatizuar ndërmarrjet në pronësi shoqërore përmes metodave të spin of-it dhe likuidimit</li> </ul>	Ligji Nr. 03/L-067, për AKP-në	<a href="http://www.pak-ks.org">www.pak-ks.org</a> <a href="http://www.assembly-kosova.org">www.assembly-kosova.org</a>
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	Dhoma e Posaçme është themeluar për të shqyrtuar kërkesat e kreditorëve dhe të pronësisë që rrjedhin nga procesi i privatizimit.	RREG. E UNMIK-ut/2002/13	<a href="http://www.pak-ks.org">www.pak-ks.org</a> <a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a>
Shfrytëzimi i Tokës	Kjo rregullore, konverton, të drejtat për shfrytëzimin e tokës që kanë ndërmarrjet të përfshira në privatizimin me spin of-e, në kontratë për qira për 99 vjet që mund të transformohet lehtë dhe të shfrytëzohet si garancion për sigurimin e kredive.	UNMIK/REG/2003/13	<a href="http://www.pak-ks.org">www.pak-ks.org</a>
Investimet e Huaja	<ul style="list-style-type: none"> <li>Investimet e huaja do të udhëhiqen sipas parimit të trajtimit kombëtar, që do të thotë se ato do të trajtohen hiq më pak favorshëm se sa ndërmarrjet e ngjashme vendore;</li> <li>Investimet e huaja do të mbrohen nga shpronësimet e paarsyeshme;</li> <li>Të hyrat nga investimet e huaja mund të transferohen lirshëm dhe papen-gueshëm jashtë vendit dhe anasjelltas në një mënyrë të pakufizuar;</li> <li>Investitorët e huaj mund të pronësojnë pasurinë e patundshme në Kosovë dhe gëzojnë të drejtat e njëjta të pronës sa i përket pasurisë së patundshme sikurse qytetarët e Kosovës dhe subjektet ligjore.</li> <li>Investitorët e huaj mund të punësojnë kombësi të huaja.</li> </ul>	Ligji Nr. 02/L-33  Ky ligj është në fuqi së bashku me RREG e UNMIK-ut/2006/28	<a href="http://www.assembly-kosova.org">www.assembly-kosova.org</a>

<p>Administrata Tatimore dhe Procedurat</p>	<p>Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të ligjit aktual dhe çfarëdo legjislacioni tjetër që zbatohet në Kosovë i cili kërkon për të administruar çfarëdo tatimi.</p>	<p>Ligji Nr. 03/L-071 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/48 Për shpalljen e Ligjit mbi administratën dhe procedurat tatimore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës sipas Rreg. së UNMIK-ut Nr. 005/17</p>	<p><a href="http://www.pak-ks.org">www.pak-ks.org</a>  <a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a></p>
<p>Organizimet e Bizneseve</p>	<p>Janë pesë lloje të subjekteve ligjore që mund të regjistrohen për kryerjen e aktiviteteve afariste në Kosovë me procedurën e thjeshtë dhe të shpejtë të regjistrimit të biznesit brenda 3 ditëve. Këto janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Ndërmarrje Private (personale) e Biznesit</li> <li>■ Partneriteti i Përgjithshëm</li> <li>■ Partneriteti i Kufizuar</li> <li>■ Kompani aksionare</li> <li>■ Kompani me përgjegjësi të kufizuara</li> </ul>	<p>Ligji nr. 2007/02-L123</p> <p>Ky ligj zbatohet së bashku me RREG E UNMIK-ut/2008/26</p>	<p><a href="http://www.assembly-kosova.org">www.assembly-kosova.org</a>  <a href="http://www.arbk.org">www.arbk.org</a></p>
<p>Pengu</p>	<p>Rregullorja dhe themelimi i një agjencie të domosdoshme për regjistrim do të mundësonte përdorimin e të gjitha formave të pasurisë së luajtshme si garancion për kredi afariste, për biznes apo për nevoja personale. Rregullorja parasheh tri lloje të pengut:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Pengu posedimor;</li> <li>■ Pengu standard;</li> <li>■ Pengu i blerjes.</li> </ul>	<p>RREG E UNMIK-ut/2001/5</p>	<p><a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a></p>
<p>Zyra e Regjistrimit të Pengut</p>	<p>Zyra është përgjegjëse për pranimin, dorëzimin dhe arkivimin e të dhënave përkitazi me pengun e pronës së luajtshme dhe ofrimin e mundësive publikut për kërkim të pengut si dhe për mbajtjen e të gjitha shënimeve përkatëse.</p>	<p>6 Nëntor 2001, UNMIK/REG/2001/32</p>	<p><a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a></p>
<p>Ligji Themelor i Punës</p>	<p>Kjo rregullore e rregullon punësimin në Kosovë, përfshirë marrëdhëniet e punësimit sipas së cilës kryhen punët dhe shërbimet.</p>	<p>UNMIK/REG/2001/27</p>	<p><a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a></p>

<p>Bordi i Raportimit Financiar të Kosovës dhe Regjimi i Raportimit Financiar të Organizatave Afariste</p>	<p>Bordi i Raportimit Financiar (BRF) brenda AQF-së po vendos Standardet e reja të Kontabilitetit në Kosovë (SKK), të cilat do të jenë një version i thjeshtësuar i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Kërkesat minimale për të vepruar në përputhje me SKK-në janë të njëjta me ato të TVSH-së. Bizneset të cilat kanë një qarkullim që kalon 100,000€ duhet të përgatitin katër pasqyra (bilancin, deklaratën e të hyrave, pasqyrën financiare dhe ndryshimet në depozita) si dhe shënimet me tatimin në fitim. Bizneset me qarkullim nën 100,000€ duhet të përgatisin vetëm deklaratën për kthimin në tatim.</p>	<p>29 Tetor 2001, UNMIK / REG/2001/30</p>	<p><a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a></p>
<p>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar</p>	<p>Tatimi mbi vlerën e shtuar zbatohet në tarifën prej gjashtëmbëdhjetë përqind (16%) mbi vlerën e tatueshme të importeve, të hyrave dhe furnizimet tjera të tatueshme përveç furnizimet në tarifën zero.</p>	<p>Ligji nr. 2008/03-L-114 Ligji mbi tarifën e TVSH-së</p> <p>Ligji nr. 2004/48 Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat Vërejtje: Ky ligj zbatohet së bashku me RREG E UNMIK-ut 2005/17</p>	<p><a href="http://www.assembly-kosova.org">www.assembly-kosova.org</a></p> <p><a href="http://www.atk-ks.org">www.atk-ks.org</a></p>
<p>Akciza</p>	<p>Akciza zbatohet prej 10-50% të vlerës së mallrave, që ndryshon sipas prodhimit ose shumës fikse për sasinë e specifikuar që zbatohet në kafe, pijet jo-alkoolike, birra, verë, etil, alkool, pije alkoolike dhe pije tjera energjike, cigaret, duhanet tjera, veturat, derivatet, naftë për mjetet motorike dhe vajguri.</p>	<p>Ligji nr. 03-L-112 Tarifa mbi Akcizën</p> <p>Ligji nr. 03-L-109 Doganat dhe Kodi i Akcizës së Kosovës</p>	<p><a href="http://www.assembly-kosova.org">www.assembly-kosova.org</a></p> <p><a href="http://www.dogana-ks.org">www.dogana-ks.org</a></p>
<p>Tatimi Doganor</p>	<p>Një tarifë fikse e përgjithshme prej 10% është e aplikuar për të gjitha mallrat e importuara dhe 0% për ato të eksportuara. Ekziston lirimi për importet e materialit të lëndës së parë, radhitjen e mallrave kapitale dhe mallrat e lëndës së parë, mirëpo gjithashtu edhe për mallrat farmaceutike, të cilat janë me tarifë zero.</p>	<p>Ligji nr. 03-L-109 Doganat dhe Kodi i akcizës së Kosovës</p>	<p><a href="http://www.dogana-ks.org">www.dogana-ks.org</a></p>

<p>Tatimi në fitim</p>	<p>Tatimi në Fitim është një tatim në vlerë prej 10% për bizneset me qarkullim vjetor 50,000€ ose më shumë. Bizneset e vogla të cilat nuk kalojnë të hyrat bruto vjetore prej 50,000 euro mund të kenë mundësinë të tatimohen ose në të hyrat reale ose tatimit të paragjykuar.</p> <p>Tatimi në fitim është më shumë tatim në kufirin e fitimit se sa në qarkullim. Tatimi në fitim përfshin: shpenzimet e biznesit, rogat e punëtorëve, tatimet indirekte të paguara, amortizimi, pagesat për investimet e reja, mallrat, energjia elektrike.</p>	<p>Ligji nr. 03-L-113 Ligji për tatimin në fitim</p>	<p><a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a></p>
<p>Likuidimet e Ndërmarrjeve</p>	<p>Rregullorja aktuale përcakton procedurat për riorganizimet ose likuidimet e Ndërmarrjeve dhe asetëve të tyre aktualisht nën autoritetin administrativ dhe menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.</p>	<p>RREG e UNMIK-ut 2005/48 dhe UNMIK/ REG /2007/1</p> <p>Mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të tyre nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.</p>	<p><a href="http://www.unmikonline.org">www.unmikonline.org</a></p>

**Akt mohimi:** Ju lutem të keni vëmendjen se kjo listë ofron vetëm listën e përgjithshme të disa prej ligjeve dhe rregulloreve kryesore të cilat mund të kenë ndikim në aktivitetet afariste në Kosovë dhe nuk duhet të konsiderohet si një listë gjithëpërfshirëse. Informacioni është përmbledhur dhe pjesërisht është thjeshtësuar. Në veçanti, duhet të kihet parasysh që ndryshimet legjislativë dhe ndryshimet në interpretimin nga autoritetet dhe gjykatat mund të ndodhin shpesh. Pavarësisht nga përpjekja për të ushtruar kujdes në hartimin e kësaj liste, autorët nuk garantojnë saktësi, tërësi ose karakter të ditëve të sotme të përmbajtjes së saj. Çdo detyrim në pjesën e AKP-së është e larguar nga lista.



## SITË KONTAKTOHET AKP-ja

**Zyra Qendrore e AKP-së**, Prishtinë,  
Rr Ilir Konushevci, Nr. 8  
Prishtinë, Kosovë



+381 (0) 38 500 400 lokali 1287 dhe 1255 ose  
“NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE  
ME INVESTITOR”,  
Faks +381 (0) 38 248 076  
E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)

**[Ueb faqja e AKP-së www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)**



